



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 7638 prot.

Lezhë, më: 21.05 2026

### SHPALLJE

Baza ligjore: Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligji nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Në kuadër të monitorimit të kushteve klimaterike dhe studimit të potencialit të erës në territorin pyjor të Bashkisë Lezhë, njoftohen subjektet / institucionet e interesuara se:

Në zonën pyjore Mali i Kakarriqit, Njësia Administrative Balldre dhe në zonën pyjore Mali i Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin , do të zhvillohet procesi:

1. Matja e shpejtësisë dhe drejtimit të erës;
2. Vendosija e pajisjeve matëse për një periudhë të caktuar kohore 1-2 vite.

Qëllimi i këtij procesi është:

1. Mbledhja e të dhënave teknike dhe mjedisore.
2. Vlerësimi i potencialit të energjisë së erës.
3. Studimi i ndikimit në mjedisin pyjor dhe biodiversitet.

#### Të dhëna mbi zonën 1:

Vendndodhja: **Balldre**

Sipërfaqja: **1 ha**

Ngastra / N/ngastra **15**

Ekonomia pyjore: **Mali i Kakarriqit**

Koordinatat orientuese: **E 465665.36 N:4636858.66**

#### Të dhëna mbi zonën 2:

Vendndodhja: **Shëngjin**

Sipërfaqja: **1 ha**

Ngastra / N/ngastra **55**

Ekonomia pyjore: **Mali i Rrencit**

Koordinatat orientuese: **E:464847.52 N:4633987.45**

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm

1. Niptin dhe ekstraktin e QKR
2. Letrën e shprehjes së interesit në të cilën duhet të sqarohet e të argumentohet aktiviteti dhe plani i biznesit.
3. Planvendosjet e sipërfaqeve të shpallura mbi të cilën duhet të konturohet sipërfaqja e kërkuar me koordinatat përkatëse dhe segmentet e rrugës sipas parcelave pyjore për periudhën e kontratës së përdorimit.

Për informacione të mëtejshme na kontaktoni në adresën të cilën e gjeni në Web-in [www.lezha.gov.al](http://www.lezha.gov.al)

Afati i dorëzimit të kërkesave për shprehje interesi do të jetë 10 ditë pune nga data e publikimit të shpalljes.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

